

Tiranë, 15.12.2020

**AKT-THEMELIMI**  
**i**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“MEDSTAR” sh.p.k.**

**Themeluesit:**

1. z. **Anesti Nano**, shtetas shqiptar, i biri i Stavrit, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 14/04/1963, banues në Tiranë, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartë identiteti G30414231M.
2. z. **Artan Isaraj**, i biri i Shazivarin, lindur në Kuçovë dhe banues ne Tirane, i datëlindjes 15.06.1973, shtetas shqiptar, person madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar me kartë identiteti ID H30615053B.
3. z. **Sokol Isaraj**, i biri i Shazivarin, indur në Kuçovë dhe banues ne Tirane, i datëlindjes 27.06.1969, shtetas shqiptar, person madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar me kartë identiteti me nr. G90627104W.
4. z. **Fatos Jaupi**, i biri i Jakes, lindur në Berat dhe banues nëTirane, i datëlindjes 28.6.1965, shtetas shqiptar, person madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar identifikuar me kartë identiteti G50628084E.
5. z. **Adriatik Qafa**, i biri i Faikut, lindur në Berat dhe banues ne Tirane, i datëlindjes 10.12.1963, shtetas shqiptar, person madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar identifikuar me kartë identiteti G31210051S.

Në mbështetje të legjislacionit shqiptar në fuqi, respektivisht Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, sot, më datë 15.12.2020 (dymijë e njëzetë), ne themelojmë Shoqerinë Tregtare “MEDSTAR” sh.p.k., si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me të dhënat si më poshtë vijon:

**HYRJE**

Ortakët kanë të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga ushtrimi i veprimtarisë së shoqërisë. Qëllimi i këtij akti është themelimi i shoqërisë “MEDSTAR” sh.p.k., si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar .

**OBJEKTI**

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar ” MEDSTAR ” do të ushtrojë aktivitetin e saj si qendër mjekësore, në fushën pediatrike, kardiopediatrike, kirurgji vaskulare, gjinekologji dhe fertilizim in vitro, reumatologji, endokrinologji, laborator klinik- biokimik, konsulencë dhe implementim projekteve shëndetsore, hematologji, ndërryje mikrokirurgjikale. Gjithashtu, do te ushtroj çdo veprimtari tjetër që i shërben rritjes dhe zhvillimit të kësaj shoqërie në perputhje me legjislacionin shqiptar.

## KOHËZGJATJA

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per një periudhe kohore: pa afat, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

## SELIA

Shoqeria e ka seline ne : Bulevardi "Bajram Curri", Godina 12 kat, kati 1, Njësia 19, Tirane. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj. Për këtë, ajo mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjenci në të gjithë territorin e R. Sh., si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

## KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

### **Shuma dhe pagesat e kapitalit themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar "MEDSTAR" Sh.p.k., është 10.000 (dhjetemije) lek kontribut i ortakëve dhe është i ndarë në 5 (pesë) kuota. Ortakërt marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

Kontributi i ortakëve në kapitalin themeltar është si më poshtë:

- a) z. Anesti Nano zotëron 1 kuotë me vlerë 2000 lek (20%);
  - b) z. Artan Isaraj zotëron 1 kuotë me vlerë 2000 lek (20%);
  - c) z. Sokol Isaraj zotëron 1 kuotë me vlerë 2000 lek (20%);
  - d) z. Adriatik Qafa zotëron 1 kuotë me vlerë 2000 lek (20%);
  - e) z. Fatos Jaupi zotëron 1 kuotë me vlerë 2000 lek (20%);
- Ortakët e shoqërisë janë përgjegjës ndaj shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar për të gjitha detyrimet e marra përsipër dhe përgjigjen për humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.
  - Fondet monetare të shoqërisë mund të përdoren për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë së saj ekonomiko-financiare.

## ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të administrohet nga z. **Anesti NANO**, i biri i Stavrit, i datëlindjes 14/04/1963, lindur në Berat e banues në Tirane, identifikuar me kartë identiteti ID Nr. Personal 026475022, konform dispozitave të ligjit dhe parashikimeve të statutit të shoqërisë. Administratori emërohet për një periudhë 5 vjecare me të drejtë rizgjedhje.

## DISPOZITA KALIMTARE

Rregullat për organizimin dhe drejtimin e shoqërisë tregtare parashikohen hollësishët në Statutin e shoqërisë që shoqëron këtë akt themelimi.

Të gjitha mosmarrëveshjet me institucione publike ose private, me persona fizik dhe juridik do të zgjidhen me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet mirëkuptimi, cështja do të jetë në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky akt themelimi përpilohet në 5 (pesë) kopje originale, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe, një prej të cilave do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Lexuar, miratuar dhe nënshkruar.

**THEMELUESIT**  
**E**  
**Shoqërisë Tregtare “MEDSTAR” sh.p.k.**


Anesti NANO

Artan ISARAJ

Sokol ISARAJ

Adriatik QAFA

Fatos JAUPI



**S T A T U T**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

"MEDSTAR" sh.p.k.

**KREU I**

Neni 1: **Emërtimi, ortakët**

Sot, më datë 15.12.2020 (dijmijë e njëzetë), në mbështetje të legjislacionit shqiptar në fuqi, respektivisht Ligji nr. 99014 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i azhornuar, Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ndryshuar, ortakët e shoqërisë "MEDSTAR" sh.p.k., janë mbledhur për të hartuar këtë statut ku parashikohen kushtet për funksionimin dhe organizimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të së drejtës shqiptare.

Ortakët:

1. z. **Anesti Nano**, shtetas shqiptar, i biri i Stavrit, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 14/04/1963, banues në Tirane, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartë identiteti G30414231M.
2. z. **Artan Isaraj**, i biri i Shazivarit, lindur në Kuçovë dhe banues ne Tirane,i datëlindjes 15.06.1973, shtetas shqiptar, person madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar me kartë identiteti ID H306150538.
3. z. **Sokol Isaraj**, i biri i Shazivarit, indur në Kuçovëdhe banues ne Tirane, i datëlindjes 27.06.1969, shtetas shqiptar, person madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar me kartë identiteti me nr. G90627104W.
4. z. **Fatos Jaupi**, i biri i Jakes, lindur në Berat dhe banues në Tirane, i datëlindjes 28.6.1965, shtetas shqiptar, person madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar identifikuar me kartë identiteti G50628084E.
5. z. **Adriatik Qafa**, i biri i Faikut, lindur në Berat dhe banues ne Tirane, i datëlindjes 10.12.1963, shtetas shqiptar, person madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar identifikuar me kartë identiteti G31210051S.

të mbledhur me qëllim respektimin e principit "*Një shëndetësi e SIGURT fillon tek NE*" sanksionojnë kushtet e mëposhtme:

**EMËRTIMI, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA**

Neni 2: **Objekti**

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "MEDSTAR" sh.p.k., do te ushtroje aktivitetin e saj si qendër mjekësore, ne fushen pediatrike, kardiopediatrike, kirurgji vaskulare, gjinekologji dhe fertilizim in vitro, reumatologji, endokrinologji, laborator klinik- biokimik, konsulencë dhe implementim projekteve shëndetsore, hematologji, ndërhyrje mikrokirurgjikale. Gjithashtu, do te ushtroj çdo veprimtari tjeter qe i sherben rritjes dhe zhvillimit te kesaj shoqerie ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Klinika MEDSTAR" sh.p.k.,

Faqe 1 deri 14

### Neni 3: Kohëzgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per një periudhe kohore : Pa afat, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

### Neni 4: Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar është "**MEDSTAR**" sh.p.k.

### Neni 5: Selia

**5.1** Shoqeria e ka seline ne : Bulevardi "Bajram Curri", Godina 12 kat, kati 1, Njësia 19, Tirane.

**5.2** Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj. Për këtë, ajo mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjenci në të gjithë territorin e R.Sh., si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

## KREU II Kapitali themeltar i shoqërisë

### Neni 6: Shuma dhe pagesat e kapitalit themeltar

**6.1** Kapitali themeltar i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të kufizuar "Klinika MEDSTAR" Sh.p.k., është 10.000(dhjetemije) lekë kontribut i ortakëve dhe është i ndarë në 5(pesë) kuota. Ortakët marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

**6.2** Kontributi i ortakëve në kapitalin themeltar është si më poshtë:

- a) z. Anesti Nano zotëron 1 kuotë me vlerë 2000lek (20%);
- b) z. Artan Isaraj zotëron 1 kuotë me vlerë 2000 lek (20%);
- c) z. Sokol Isaraj zotëron 1 kuotë me vlerë 2000 lek (20%);
- d) z. Adriatik Qafa zotëron 1 kuotë me vlerë 2000 lek (20%);
- e) z. Fatos Jaupi zotëron 1 kuotë me vlerë 2000 lek (20%);

### Neni 7: Kërkesa për të paguar kuotat e kapitalit dhe têrheqja e kuotave të papaguara

**7.1** Administratori mund t'u kërkojë ortakëve të paguajnë kontributin e papaguar në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak, në varësi të marrjes së një njoftimi prej të paktën, 30 (tridhjetë) ditësh të plota, që përcakton kohën dhe vendin se ku duhet të bëhet pagesa, i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e veta, si përcaktohet në njoftim. Thirrja për pagesë mund të kërkojë që pagesa të bëhet me këste. Personi të cilit i drejtohet thirrrja për pagesën e kontributit përgjigjet për thirrjet që i bëhen pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet thirrrja për pagesë.

**7.2** Zotërueshit e përbashkët të një kuote, mbajnë përgjegjësi bashkërisht dhe veçmas për të shlyer të gjitha thirrjet për pagesë të kontributit, të cilat lidhen me këtë kuotë.

7.3 Nëse një thirrje për pagesë mbetet e papaguar pas mbarimit të afatit, Administratori mund t'i japë një njoftim prej jo më pak se 30 (tridhjetë) ditësh të plota personit që është përgjegjës për pagesën, përmes të cilit i kërkojnë të paguajë shumën e papaguar së bashku me interesin që mund të jetë akumuluar. Në njoftim jepet emri i vendit ku duhet bërë pagesa dhe në të deklarohet se nëse nuk zbatohet, kuotat e pronësisë me të cilat lidhet njoftimi, përgjigjen duke u anuluar.

**Neni 8: Kuotat, të drejtat dhe kufizimet**

8.1 Në varësi të dispozitave të Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, çdo kuotë mund të emëtohet me të drejta ose kufizime të tillë siç përcaktohet në vendimin e kualifikuar me 75% (*shtatëdhjetë e pese përqind*) të kapitalit të Asamblesë së Përgjithshme.

8.2 Ortakët e shoqërisë janë përgjegjës ndaj shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar për të gjitha detyrimet e marra përsipër dhe përgjigjen për humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

**Neni 9: Certifikatat e kuotave të kapitalit**

9.1 Ortaku, në momentin e marrjes së pronësisë së kuotave të kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë një certifikatë për të gjitha kuotat që zotëron. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshoje më shumë se një certifikatë për kuotat në zotërim të përbashkët të disa personave dhe dhënia e certifikatës përfaqësuesit të zotërueshve të përbashkët sipas Nenit 72, paragrafi (2) të Ligjit përbën një dhënie të mjaftueshme për të gjithë këta zotëruesh. Emrat e zotërueshve të përbashkët renditen në certifikatën e kuotës. Ky vërtetim nuk ka natyrën e letrës me vlerë.

**Neni 10: Kalimi i kuotave me kontratë shitblerje**

10.1 Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrimdhe në bazë të formaliteteve të vendosura nga Administratori duke respektuar dispozitat ligjore përkatëse.

10.2 Kalimi i kuotave nëpërmjet shitblerjes do të realizohet vetem pasi të jetë respektuar fillimi i *drejtës e parablerjes* në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjera dëshirojnë blerjen e kuotave, me vendim të transaksi të kryhet në vlerën që kanë kuotat e përcaktuar në kapitalin fillestar themeltar të shoqërisë.

10.3. Në rastin kur shoqëria ose ortakët e tjere nuk dëshirojnë blerjen e kuotave, me vendim të asamblesë së përgjithshme, marrë me shumicë të thjeshtë, vijohet me shitjen e kuotave palëve të treta.

10.4 Administratori mund të mos pranojë ta regjistrojë kalimin e kuotës pranë QKR-së, nëse kuota nuk është shlyer tërësisht ose nëse nuk janë dakord që kuotën ta marrë marrësi.

**10.5** Nëse Administratori nuk pranon ta regjistrojë kalimin e kuotës, ata, brenda një muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në shoqëri, i dërgojnë marrësit njoftimin për mospranimin.

**Neni 11: Kalimi përmes trashëgimisë ose falimentit**

**11.1** Nëse një ortak vdes, kuota që ai zoteron do ti kalojë trashëgimtarëve të tij legitim konform parashikimeve të Kodit të Familjes dhe shoqëria i njeh si titullarë të kuotës së trashëguar.

**11.2** Bashkëzotërueshit e mbetur gjallë dhe, në rastin kur është zotëruesh i vetëm ose një bashkëzotëruesh i vetëm i mbetur gjallë, trashëgimtarët e tij, janë të vetmit persona, të cilët shqëria i njeh si titullarë të kuotës së tij; Kalimi i kuotave me trashëgimi, nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkërisht.

**11.3** Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, të vendosë ose të bëhet zotëruesi i kuotës ose të kërkøjë që si zotëruesh i kuotës të regjistrohet një person tjeter i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotëruesh vetë, ai e njofton shqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkøjë që si zotëruesh i kuotës të regjistrohet një person tjeter, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës tek ky person tjeter, duke respektuar të drejtën e parablerjes së ortakëve aktualë të shoqërisë në rastin e kalimit të kuotës me shitblerje.

**11.4** Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku gjzon të drejtat, titullar i të cilave do të kishte qenë si zotëruesh i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpala se të regjistrohet pranë QKR-së, ai nuk gjzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në asamblenë e shoqërisë.

**Neni 12: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

**12.1** Asambleja e Përgjithshme mund ta zmadhojë kapitalin, me vendim të kualifikuar, duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues me shumat që përcaktohen në vendimin e marrë prej saj. Në këtë rast, vendimi duhet gjithmonë të merret me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 75% (shtatëdhjetepësë përqind) të kapitalit. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar, të gjithë ortakët do të kenë të drejtë të nënshkruajnë zmadhimin e tij në proporcion me pjesët e tyre në kapital. I njëjti vendim i kualifikuar kërkohet edhe kur zmadhimi i kapitalit pritet t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.

**12.2** Me anë të një vendimi të kualifikuar, shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e vet. Në këtë rast, vendimi duhet gjithmonë të merret me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 75 % (shtatëdhjetepësë përqind) të kapitalit. Në rast zvogëlimi të kapitalit themeltar, të gjithë ortakët do të kenë të drejtë të nënshkruajnë zvogëlimin e tij në proporcion me pjesët e tyre në kapital. Në çdo rast, kapitali i shoqërisë nuk mund të

zvogëlohet nën kufirin e parashikuar me ligj.

**12.3** Objekt shqyrtimi nga asambleja e përgjithshme do të jetë vlerësimi i ecurisësë veprimtarisë së shoqërisë që do të bëhet të paktën një herë në vit.

**Neni 13: E drejta e parablerjes**

**13.1** Ortakët e shoqërisë kanë përparësi për blerjen e pjesës që shitet përpara personave të tretë jashtë shoqërisë. Ortaku që dëshiron të transferojë ose të shesë kuotat e tij i drejton një kërkesë me shkrim asamblesë, duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i njëjtë me vlerën që kanë kuotat sipas kapitalit fillestar themeltar të shoqërisë. Ortakët në këtë rast duhet të jepin një përgjigje brenda 60 ditëve. Edhe e drejta e parablerjes, duhet t'u jepet me shkrim duke iu drejtuar asamblesë.

**13.2** E drejta e parablerjes është proporcionale me kuotat e secilit prej ortakëve, por nëse një ortak nuk është i interesuar, tjetri mund t'i blejë kuotat që shiten

**13.3** Asambleja pasi ka kaluar afati prej 60 (*gjashtëdhjetë*) ditëve, brenda 30 (*tridhjetë*) ditëve i komunikon ortakut që shet kuotat e tij, vendimin e ortakëve të tjerë për të blerë të gjithë ose pjesërisht kuotat e tij. Në rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë këto kuota brenda 60 (*gjashtëdhjetë*) ditëve i ofrohen personave të tretë jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave, duhet të bëhet në formë shkresore.

**KREU III  
ORGANET DREJTUESE**

Shoqëria ka si organe drejtuese:

1. Asambleja e Përgjithshme
2. Administratori

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

**Neni 14: Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme**

**14.1** Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare" si edhe nga ligje të tjera si edhe nga statuti.

Asambleja e Përgjithshme mblidhet me kërkesë të Administratorit, sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë, cdo rast të kërkuar nga ortakët konform nenit 84 të Ligjit.

**14.2** Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme thirret me anë të një letre ose një mesazhi me postë elektronike, që i drejtohet secilit prej ortakëve, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të bëhet të paktën 7(*shtate*) ditë të plota kalendarike përpara mbledhjes, por kjo periudhë mund të jetë edhe më e shkurtër

nëse këtë e aprovojnë shumica e ortakëve që zoterojnë jo më pak se pesëdhjete përqind të vlerës nominale të kuotave. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe PIN-i për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin në mbledhje.

- 14.3** Mosveprimi i paqëllimitë për dhënien e njoftimit për mbledhjen apo mos-marrja e njoftimit për mbledhjen nga personat që kanë të drejtën për ta marrë një njoftim të tillë i bën të pavlefshme punimet e mbledhjes, nëse shoqëria nuk provon se personi që nuk e ka marrë njoftimin i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

**Neni 15: Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

- 15.1** Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme nuk mund të fillojnë nëse nuk është i pranishëm kuorumi i parashikuar në këtë statut. Ortakët ose zotéruesit e prokurave të votimit, mund të jenë të pranishëm edhe përmes mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën, qoftë kjo përmes lidhjes me audio ose përmes lidhjes me audio dhe video, sipas Nenit 88 të Ligjit. Ortakët që marrin pjesë përmes mjeteve elektronike kanë të drejtë të votojnë pasi të paraqesin PIN-in, që u është dhënë së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

- i) Asambleja e Përgjithshme e ortakëve do të konsiderohet se është mbledhur rregullisht dhe se mund të marrë vendime të vlefshme nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30% (*tridhjetë përqind*) të kuotave, përvèç kur bëhet fjalë për rastet e parashikuara në paragafin e mëposhtëm (ii).
- ii) Asambleja e përgjithshme e ortakëve shqyrton dhe merr vendime, me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 75% (*shtatëdhjetepesë përqind*) të kapitalit themeltar për çështjet në vijim:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) për përcaktimin e investimeve, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Klinikës dhe specialiteteve strategjike të saj;
  - c) ndryshimet e statutit;
  - d) miratimi i Kushteve teknike si modifikimi dhe përshtatja e Klinikës (duke përfshire hapësirat/ambientet – zgjerim i sallave, shtimi i shtreterve, ose cdo pajisje mjekesore);
  - e) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - f) emërimin e shkarkimin e likuiduesve;
  - g) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
  - h) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - i) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - j) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - k) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

- I) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- II) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;
- III) Asambleja e përgjithshme e ortakëve shkarkon administratorin me shumicë të zakonshme votash.

**15.2** Administratori cakton një Kryetar për të drejtuar punimet e mbledhjes dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.

**15.3** Pavarësisht nëse është apo jo ortak, Administratorit i lejohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

**15.4** Me pëlqimin e mbledhjes në të cilën është i pranishëm kuorumi, Kryetari mundet (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon asambleja), t'i shtyjë punimet e Asamblesë, por në një mbledhje të shtyrë të Asamblesë nuk mund të diskutohet asnjë pikë me përjashtim të pikave të cilat mund të ishin zgjidhur rregullisht nëse nuk do të ishin ndërprerë dhe shtyrë punimet e Asamblesë. Kur punimet e Asamblesë janë shtyrë për katërmbëdhjetë ditë ose më shumë, duhet dhënë një njoftim prej të paktën shtatë ditësh të plota në të cilin përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe natyra e përgjithshme e pikave të punës që duhen kryer. Përndryshe, asnjë njoftim i tillë nuk do të ishte i nevojshëm.

**15.5** Vendimet që duhen aprovuar përmes votimit të Asamblesë merren me votë të hapur, nëse, përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk është kërkuar në mënyrë të rregullt një votim i fshehtë. Votimin e fshehtë mund ta kërkojë 1. Kryetari; ose 2. një ortak ose disa ortakë që përfaqësojnë jo më pak se 5% (*pesë përqind*) të votave gjithsej të asamblesë së shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një person që ka prokurë votimi nga një ortak ka të njëjtën vlerë sikur ta bëjë ortaku në fjalë.

#### **Neni 16: Votat e ortakëve**

**16.1** Në varësi të tëdrejtave ose kufizimeve të lidhura me kuotat, secila kuotë e një ortaku i cili (si individ) është i pranishëm vetë ose përmes një prokure përfaqësimi ose (si shoqëri) është i pranishëm përmes përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt ose përmes një prokure përfaqësimi ka të drejtën e një vote.

**16.2** Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme personalisht ose përmes një prokure përfaqësimi, në lidhje me kuotat që zoteron vetë, nëse nuk janë paguar tërësisht kontributet nga ana e tij në lidhje me kuotën në fjalë

**16.3** Kundërshtimet e ngritura për plotësimin e kushteve nga ana e një votuesi i bëhen në kohë Kryetarit, vendimi i të cilit është i formës së prerë. Të gjitha votat e pahequra në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë janë të vlefshme.

#### **Neni 17.1: Hetimet e posaçme**

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një

audituesi të posaçëm sipas Nenit 91 të Ligjit e bëjnë një kërkesë të tillë përmes depozitimit në selinë e shoqërisë të një dokumenti së bashku me një deklaratë notieriale e cila vërteton se personi ose personat i plotësojnë kushtet për këtë veprim.

### Neni 17.2 Menaxhim financiar dhe sanitari

Me qëllim kontrollin dhe zbatimin e transparencës financiare, cdo mjek i punësuar në Klinikën MEDSTAR sh.p.k., ngarkohet të përcaktoj ose sugjeroj një punonjës, pjesë e stafit, i cili do të evidentoj gjithë lëvizjet/ punën ditore të kryera duke mbajtur kështu raporte ditore dhe mujore për ortakët;

Në rastin kur ortaku i shoqërisë "Klinika MEDSTAR" sh.p.k., luan edhe rolin e stafit mjekësor, do të përfitoj për shkak të marrëdhënies kontraktuale një shumë e barazvlefshme prej 50% të saj për cdo ndërhyrje mikrokirurgjikale dhe ndarjen në divident, në përputhje me vlerën e kuotës që zotëron;

Ortakët zotohen të respektojnë parashikimet e Kodit të Etikës së shoqërisë "Klinika MEDSTAR" shpk. duke mbajtur përgjegjësi individuale (penale, civile, administrative) për cdo veprim/funksion/ detyrë të kryer me dashje dhe/ose nga pakujdesia që dëmton klinikën qoftë financierisht ashtu edhe në imazh.

### KREU IV

### ADMINISTRATORI

### Neni 18: Emërimi i administratorit

**18.1** Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të vetëm të shoqërisë për 5 (pesë) vjet sipas Nenit 81 paragrafi (1) pika 3 dhe Nenit 95 të Ligjit. Emëritet i nënshtrohen individualisht një vendimi me votën pro të shumicës se zakonshme, të kapitalit themelues, nëse miratohet, çon në zgjedhjen e personit të propozuar si administrator.

**18.2** Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorit parashikohen në Nenin 95, paragrafi (2) i Ligjit.

**18.3** Shoqëria do të drejtohet nga Administratori z. **Anesti Nano**, shtetas shqiptar, i biri i Stavrit, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 14/04/1963, banues në Tiranë, person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me kartë identiteti ID Nr.026475022.

### Neni 19: Kompetencat e Administratorit

**19.1** Veprimtaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga Administratori, i cili mund t'i ushtrojë të gjitha kompetencat e shoqërisë që nuk i janë rezervuar Asamblesë së Përgjithshme nga Neni 81 i Ligjit.

**19.2 Administratori ka këto të drejta dhe detyrime:**

- të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- të përfaqësojë shoqërinë, në mënyrë aktive ose pasive, përpara çdo autoriteti gjyqësor, administrativ, fiskal, në çdo procedurë, në çdo shkallë të gjykimit, si në Shqipëri ashtu dhe jashtë saj, me të drejtën për të nënshkruar çdo akt ose dokument të nevojshëm sipas rastit, personalisht ose duke ndjekur formalitetet përkatëse, pra, edhe me lëshimin e prokurave, mandateve të veçanta për avokatë, mbrojtës, të përgjithshme dhe për mosmarrëveshje; të lëshojnë ose të revokojnë mandate *ad lites* avokatëve dhe mbrojtësve dhe *ad negotia* punonjësve të shoqërisë ose të tretëve për një ose më shumë veprime, në kuadër të kompetencave përkatëse;
- të kryejë çdo operacion financier dhe/ose tregtar (kontrata *leasing*; operacione cedimi kredie) aktive dhe pasive, që ka lidhje me operacione që hyjnë në objektin e shoqërisë, duke marrë përsipër angazhime dhe përbushje të formaliteteve të nevojshme, duke përfshirë dorëzaninë;
- të çelë llogari rrjedhëse bankare, të kryejë tërheqje parash, të japë dispozita të pagesës, të firmosë çeqe që të kenë vlerë tek këto llogari rrjedhëse, edhe të zbuluar, në kufijtë e besueshmërisë së atij momenti (*overcover*), të verifikojë këto llogari rrjedhëse dhe të miratojë llogarinë;
- të punësojë, të pezullojë, të pushojë nga puna dhe të ndryshojë kushtet që lidhen me marrëdhëni e punës së personelit;
- të ndërveprojë me Entitet e Administratës Publike për çdo negocim që lidhet me oferta, projekte, pjesëmarrje, gjithnjë brenda kufijve të parashikuar nga objekti i shoqërisë;
- të lëshojë ekstrakte të borderove dhe vërtetime që lidhen me personelin, si për entet e sigurimeve shoqërore, ashtu dhe për ente të tjera ose private; të kujdeset për respektimin e përbushjeve, ndaj të cilave shoqëria është e detyruar, me të drejtën për të nënshkruar deklarata tatimore, që kanë lidhje me mbajtjet nga të ardhurat e punës së varur ose autonome që janë përdorur;
- të nënshkruajë deklarata fiskale në lidhje me taksat dhe tatimet në përgjithësi, si dhe çdo akt ose certifikatë të parashikuar nga legjislacioni fiskal në fuqi, të kërkojë rimbursime dhe lehtësimë nga taksat dhe tatimet, të përfaqësojë shoqërinë përpara organeve të administratës fikale dhe pranë komisioneve tatimore të çdo shkalle, me të drejtën për të emëruar mbrojtës të posaçëm;
- të përfaqësojë shoqërinë pranë organeve publike, tatimore dhe administrative, edhe me qëllim fitimin e koncesioneve, licencave dhe lejeve, duke emëruar, nëse është e nevojshme edhe mbrojtës të posaçëm;
- të nënshkruajë komunikimet e bankës mbi kryerjen e akreditimit dhe borxhit në llogari rrjedhëse dhe ekstrakteve periodike të llogarive rrjedhëse për vartësit e shoqërisë për shumat e depozituara pranë saj;
- të nënshkruajë kontrata shitblerje të mallrave dhe shërbimeve, në kufijtë e objektit të shoqërisë;
- të ndërtøjë, të përfundojë dhe të administrojë marrëdhënie bankare, duke rënë dakord mbi afatet dhe kushtet;

- të kryejë çdo formalitet për firmosjen e një akti dhe/ose dokumenti me qëllim depozitimin e akteve dhe dokumenteve të shoqërisë pranë Gjykatës, Dhomës së Tregtisë, Zyrave Fiskale dhe Enteve të tjera;
- të përfaqësojë shoqërinë në asambletë e shoqërive të tjera, shoqatave, konsorciumeve dhe në marrëdhëniet me këto ente, organet e tyre dhe ortakët ose të asociuarit e tyre, dhe të emërojë përfaqësues, të delegojë me mandat dhe/ose prokurë, aq sa i takon kompetencave të tij.

- 19.3** Administratori mund t'ia delegojë kompetencat e tij komiteteve që përbohen nga një ose më shumë anëtarë. Një delegim i tillë mund të bëhet në varësi të kushteve që mund të vendosë Administratori dhe mund të revokohet ose të ndryshohet.
- 19.4** Asnjë ndryshim i Statutit dhe asnjë direktivë nga ana e Asamblesë së Përgjithshme nuk mund t'i bëjë të pavlefshme veprimet e mëparshme të Administratorit, të cilat do të kishin qenë të vlefshme, nëse nuk do të ishte bërë ndryshimi apo nëse nuk do të ishin dhënë direktiva.

- 19.5** Administratori nuk mund të delegojë asnjëren prej detyrimeve, të cilat ia ngarkon ligji.

#### Neni 20 : Shkarkimi / largimi i administratorit

##### **20.1 Shkarkimi i administratorit ndodh kur:**

- a) jep dorëheqjen për shkaqe të arsyeshme, përmes një njoftimi që i bën Shoqërisë;
- b) a munguar për më shumë se tre muaj radhazi pa leje në aktivitetin e përditshëm të shoqërisë;
- c) kur vuan nga sëmundje mendore e cila bën të pamundur ushtrimin e veprimitarisë së tij personale;
- d) Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Ortakëve të tjerë vendos shkarkimin e tij.

#### Neni 21: Shpërblimi i punës, përfitimet e tjera dhe shpenzimet e Administratorit

**21.1** Administratori ka të drejtë të marrë shpërblim për punën e tij, sipas vendimit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të marrë në përputhje me Nenin 97 të Ligjit.

**21.2** Asambleja e Përgjithshme mund të japë përfitime, në të holla, pensione, sigurime ose forma të tjera, për ata persona të cilët kanë punuar më parë për shoqërinë ose për shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë filiale të shoqërisë ose për shoqëri pararendëse të shoqërisë ekzistuese, ose për familjarë të tyre (përfshirë bashkëshortin, bashkëshorten, ish-bashkëshortin ose ish-bashkëshorten) ose për persona të cilët janë në varësi të tyre, dhe mund të japë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla (si përparrë ashtu dhe pasi personi në fjalë pushon së mbajturi postin ose marrëdhënien e punës).

## Neni 22: Vendimet e Mbledhjeve të Administratorit

22.1 Mbledhjet e Administratorit mbahen sa herë ta kërkojë aktiviteti i shoqërisë.

22.2 Të gjitha aktet e kryera nga Administratori ose nga një person që ushtron detyrën e caktuar nga Administratori, pavarësisht faktit nëse më vonë zbulohet se ka pasur mangësi në emërimin e tij ose ka qenë i skualifikuar nga e drejta për të mbajtur detyrën ose nuk ka pasur të drejtë vote, janë të vlefshëm njësoj sikur të gjithë këta persona të ishin emëruar rregullisht, të plotësonin kushtet, të vazhdonin të ishin Administratorë.

## Neni 23: Kufizimet për votimin

23.1 Një Administrator nuk lidh asnjë marrëveshje dhe nuk merr vendime për asnjë çështje në të cilën ka, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, një interes ose detyrë me rëndësi materiale dhe që bie ose mund të bjerë ndesh me interesat e shoqërisë sipas nenit 13 të Ligjit, nëse me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nuk kanë rënë dakord:

1. të autorizojnë lidhjen e marrëveshjes nga ana e tij dhe,
2. ta autorizojnë të vendosë për çështjen në fjalë.

23.2 Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të veçantë. Çdo aprosim i përgjithshëm duhet të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

23.3 Një Administrator nuk konsiderohet si pjesëtar i kuorumit të pranishëm në një mbledhje në lidhje me një vendim për të cilin nuk ka të drejtë vote. Për përashtimin e Administratorit nga marrja e vendimit në një mbledhje të tillë zakonisht zbatohet përkatësisht Neni 89 i Ligjit.

## Neni 24: Prosesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme

24.1 Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

24.2 Prosesverbalit duhet të përbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

24.3 Prosesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

24.4 Prosesverbalit i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

24.5 Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga

data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

## KREU V

### Dividendët dhe kapitalizmi i fitimeve

#### Neni 25: Dividendët

**25.1** Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

**25.2** Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimi shtesë se shpëndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpëndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

**25.3** Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

**25.4** Me përashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen kuotave, të gjithë dividentët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat në lidhje me të cilat paguhet dividenti. Të gjithë dividentët përpjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim me shumat e paguara për kuotat gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividenti. Por, nëse kuotat emetoohen me kushtin se merr divident, duke filluar nga një datë e caktuar atëherë kuota në fjalë e merr dividentin sipas këtij kushti.

**25.5** Nëse një divident nuk është térhequr pas dymbëdhjetë vjetëve nga data kur mund të térhiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky divident mund të anulohet dhe shoqëria nuk është e detyruar ta paguajë.

#### Neni 26: Kapitalizimi i fitimeve

**26.1** Bazuar në parimet e parashikuara në nenin 14 të Ligjit dhe pas marrjes së vendimit nga Asamblea e Përgjithshme, Administratori mund të vendos të kapitalizoj fitimet e pashpërndara të shoqërisë që nuk kërkohen për të paguar dividente preferenciale ose borkhe të tjera të pashtyera ende nga shoqëria dhe kapitali i detyruar i shoqërisë.

## KREU VI

### Prishja dhe Njoftimet

#### Neni 27: Prishja dhe Likuidimi

**27.1** Në rast mbarimi, shoqëria duhet të likujdohet duke iu nënshtruar procedurave të

likuidimit.

**27.2** Administrimi i procedurës së likuidimit bëhet nga një ose disa likuidatorë të emëruar nga Asambleja e Përgjithsme, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për përfundimin e saj.

**27.3** Likuiduesi, në përputhje me Ligjin mund t'i shpërndajë ortakëve të gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë midis ortakëve.

**Neni 28: Njoftimet**

**28.1** Njoftimet që i jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit, duhet të janë me shkrim ose përmes komunikimit elektronik në adresën e parashikuar në Nenin 4, parografi (8) të këtij statut që është i vlefshëm në momentin që i bëhet e ditur për këtë qëllim personit që bëri njoftimin.

**28.2** Shoqëria mund t'i japë një njoftim një ortaku ose personalisht ose duke ia nisur me poste në një zarp për të cilin është paguar edhe kthimi i përgjigjes në adresën e regjistruar të ortakut ose duke ia lënë në këtë adresë ose duke ia dhënë përmes komunikimit elektronik në adresën që është e vlefshme për momentin dhe i është bërë e ditur shoqërisë nga ana e ortakut. Kur ka bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve në përputhje me Nenin 7, paragrafin (2) të Ligjit.

**28.3** Në këtë statut, përfshihen shtesa dhe ndryshime dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikatat dhe procesverbalet e shoqërisë, vendosen nga Administratori në hapësirën në internet të shoqërisë të parashikuar në Nenin 4, parografi (2) i këtij Statuti.

**Neni 29: Dispozita të përgjithshme**

**29.1** Përsa i përket çështjeve që nuk janë parashikuar nga ky statut, do të aplikohen dispozitat e Shoqërive me Përgjegjësi të kufizuar sipas Ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

**29.2** Selia e shoqërisë duhet të ketë të mbishkruar pas kësaj të paktën emrin e shoqërisë, numrin e vendimit dhe vitin e inkorporimit dhe fjalët “Vula e shoqërisë”.

**29.3** Çdo mosmarrëveshje që del nga kjo marrëveshje do të caktohet para gjykatës së vendit, ku ndodhet zyra e regjistruar e shoqërisë.

**Neni 30: Dispozita përfundimtare**

Ky Statut përpilohet në 4 (katër) ekzemplarë origjinalë, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe dhe një prej te cilave, do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Ngarkohet z. Artan Isaraj, i datëlindjes 15.06.1973, shtetas shqiptar, person madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar me kartë identiteti ID H306150538. për të depozituar statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë "MEDSTAR" sh.p.k. në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe për të kryer të gjitha procedurat dhe dokumentacionet e nevojshëm për regjistrimin e shoqërisë "MEDSTAR" shpk, ose veprime të tjera të nevojshme pranë këtij institucioni shteturor.

Statuti mbylljet me 30 (tridhjetë) nene.

Lexuar, miratuar dhe nënshkruar.

#### ORTAKËT

Shoqërisë Tregtare "MEDSTAR" sh.p.k.,

Anesti NANO

Artan ISARAJ

Sokol ISARAJ

Adriatik QAFA

Fatos JAUPI

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE TIRANË**  
**NOTER MIRANDA F. XHEMALÇE**



V2020053270262025033

**DATE 15/12/2020**  
**NR REP 3851**

**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Në Tiranë, sot më date 15.12.2020, para meje Noteres Miranda F. Xhemalçe, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Bulevardi "Zhan D'Ark", Pallati 21/1, Shkalla 1, Apartamenti 1, u paraqitën personalisht:

**Nëshkruesit:**

- Z. Anesti Nano**, shtetas shqiptar, atësia Stavri, lindur më datë 14.04.1963 në Berat, me vendbanim në Tiranë, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga Letërnjoftimi ID me nr. personal G30414231M.
- Z. Artan Isaraj**, shtetas shqiptar, atësia Shazivar, lindur më datë 15.06.1973 në Kuçovë, me vendbanim në Tiranë, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga Letërnjoftimi ID me nr. personal H30615053B.
- Z. Sokol Isaraj**, shtetas shqiptar, atësia Shazivar, lindur më datë 27.06.1969 në Kuçovë, me vendbanim në Tiranë, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga Letërnjoftimi ID me nr. personal G90627104W.
- Z. Fatos Jaupi**, shtetas shqiptar, atësia Jake, lindur më datë 28.06.1965 në Berat, me vendbanim në Tiranë, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga Letërnjoftimi ID me nr. personal G50628084E.
- Z. Adriatik Qafa**, shtetas shqiptar, atësia Faik, lindur më datë 10.12.1963 në Berat, me vendbanim në Tiranë, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga Letërnjoftimi ID me nr. personal G31210051S.

Personat e lartpërmendur, me vullnetin e tyrë të lirë e të plotë, paraqiten dhe nënshkruajnë përparrë meje noteres "Statutin" e shoqërisë me përgjegjesi të kufizuar "**MEDSTAR**" sh.p.k., sipas akteve bashkëlidhur, të cilat janë hartuar nga themeluesit.

Unë noterja, pasi verifikova identitetet e personave të paraqitur, në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërmë "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005;

**Vërtetoj nënshkrimet e vendosura në Statutin  
e shoqërisë "MEDSTAR" sh.p.k.**

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do t'ë ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

